	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-29
	Prishtinë	v. 1.1	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i vendit të punës

Data e hyrjes në fuqi: 20.05.2024

Pozita:

PRAKTIKANT/E Zyrtar/e për informim

Përmbledhje

Praktikanti është përgjegjës për të kryer detyra që lidhen me informimin e palëve të treta rreth punës dhe aktiviteteve të Qendra për Arsim e Kosovës – KEC.

Kualifikimet


- Të jetë student i vitit të fundit në fakultet apo i sapo diplomuar në fushën e komunikimit, marrëdhënie me publikun, marketing ose fushë të ngjashme;
- Të ketë njohuri solide të fushës së komunikimit dhe platformave të ndryshme të mediave sociale dhe ueb-faqeve.;
- Të ketë njohuri të mira të të kuptuarit dhe shkruarit të gjuhës shqipe dhe angleze;
- Të ketë iniciativë për të propozuar ide të reja dhe qasje kreative në zgjidhjen e problemeve;
- Të ketë njohuri solide në përdorimin e platformave të dizajnit dhe pakove standarde softuerike, me qëllim të organizimit të punës.

Aftësitë tjera

- Aftësi të shkëlqyera komunikuese, shkrim dhe të folurit në mënyrë të qartë;
- Aftësi të mira të prezantimit;
- Aftësi të mira organizative;
- Aftësi të mira të hulumtimit dhe përpunimit të të dhënave;
- Aftësi për të punuar nën stres.

Detyrat

- Përkrahje rreth organizimit të informimit të rregullt për aktivitetet e KEC;
- Dokumentimi i aktiviteteve të KEC;
- Përkrahje në mirëmbajtjen e ueb faqes së KEC;
- Përkrahje në mirëmbajtjen e faqeve të KEC në rrjetet sociale;
- Komunikim i rregullt me media, partnerë dhe publikun;

	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-29
	Prishtinë	v. 1.1	Faqe 2 nga 2

- Përkrahje në përgatitjen e materialeve promovuese;
- Përkrahje në përgatitjen teknike të publikimeve;
- Kryerja e detyrave administrative nga fushëveprimi i vet dhe e detyrave të tjera në pajtim me kualifikimin e vet.

Lidhjet dhe raportimet

Praktikanti i raporton zyrtarit për informim ose personit që e cakton drejtori ekzekutiv.

Orët e punës

Praktikanti ka orar të plotë të punës prej 8 orëve në organizatë. Sipas nevojës, ofrohen lehtësime për ndjekjen e ligjëratave, provimeve, ndjekjen e trajnimeve dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me ngritjen profesionale.

Kompensimi

Kompensimi i Praktikantit bëhet konform kontratës së punës dhe mund të ndryshohet apo të modifikohet varësisht prej rezultateve të vlerësimit të performancës.